



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 261 prot.

Tiranë, më 05. 02. 2021

V E N D I M

Nr. 22, datë 05. 02. 2021

Mbështetur në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: “*Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*”, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni i marrë në ankesën Nr. 29, datë 27.04.2020, të paraqitur nga 2 ish minatorë¹, me urdhërin Nr. 61, datë 27.05.2020, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me faljen e detyrimeve ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar informacionit të administruar, pas mbylljes së punës dhe aktivitetit të Gjeologji Minerave, në vitin 2000 dhe si rezultat i papunësisë së krijuar, qeveria e asaj kohe miratoi ligjin nr. 8685, datë 09.11.2000 “*Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë*” dhe në zbatim të tij, miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 15.02.2001 “*Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, nëntokë*”. Sipas këtyre parashikimeve ligjore punonjësit e papunë të nëntokës përfitonin një trajtim të veçantë prej 5148 lekë dhe një pjesë e tyre me shumën 6500 lekë. Duke qenë se kjo shumë nuk i mbulonte nevojat jetike të kësaj kategorie, një pjesë e tyre pavarësisht trajtimit të veçantë, kanë vijuar të punojnë në punë të tjera duke përfituar njëkohësisht edhe pagesën e si ish punonjës të minierave.

Pavarësisht ndryshimeve të pësuar në vitin 2005 dhe në vitin 2007, ligji nr. 8685, datë 09.11.2000 “*Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë*”,

¹ Shtetasit P. M. dhe S. B.

parashikonte se: *“Personi, që ka përfituar të ardhura, në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të trajtimit të veçantë.”*

Sipas ankuesve, duke qënë se kategoria e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, nuk ka patur dijeni mbi parashikimin e sipërcituar, ka krijuar detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, pasi nuk kanë deklaruar punësimin e tyre dhe nuk kanë kërkuar heqjen e trajtimit të veçantë për periudhën që kanë qënë të punësuar.

Me miratimin e ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*, i cili parashikonte uljen e moshës së daljes në pension pleqërie në 55 vjeç, një pjesë e kësaj kategorie përfituan pension pleqërie, por vazhduan edhe të punojnë, duke krijuar kështu detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

Me miratimin e ligjit nr. 72/2017 *“Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfutimit të pensionit”*, kategorisë së personave të cilët kanë përfituar pension pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014 dhe njëkohësisht kanë punuar, i janë falur të gjithë detyrimet ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore deri më datë 31.12.2016.

Përsa më sipër, ankuesit pretendojnë se kategoria e personave që janë trajtuar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 *“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”*, është vënë në kushte të pabarabarta dhe diskriminuese në raport me personat që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*, pasi vetëm për këtë kategori janë falur detyrimet e akumuluar ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

Në përfundim, ankuesit kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masat që edhe personat që janë trajtuar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 *“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”* dhe kanë detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, tu falen këto detyrime dhe të trajtohen si kategoria e personave që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga*

diskriminimi”². Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 620/1, datë 28.05.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, lidhur me pretendimet e ngritura nga subjektet ankues në mbrojtje të ish Minatorëve të trajtuar me ligjin Nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Me shkresën⁴ nr. 9790/1, datë 10.06.2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “...Rasti i pensionit sipas ligjit nr. 150/2014, ‘Për pensionet e

² Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 620/3 prot., datë 15.06.2020

punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë’, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit’, shpesh krahasohej me rastin e pensionistit të zakonshëm që është subjekt i përfitimit sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, i cili vazhdon punën (në sektorin privat) por të heq edhe pensionin. Nisur nga kjo bëhej interpretimi që edhe pensionistit (minatorit) që përfiton nga ligji nr. 150/2014 mund t’i lejohej një gjë e tillë, por në fakt ka një ndryshim shumë të madh, pasi në rastin e pensionistit të zakonshëm, masa e pensionit lidhet drejtëpërdrejtë me kontributin e derdhur, ndërsa në rastin e pensionistit (minatorit) subjekt i përfitimit sipas ligjit nr. 150/2014, këta të fundit dalin në pension 10 vjet më parë (në moshën 55 vjeç) se pensionisti i zakonshëm dhe shpenzimet për këtë përballohen nga Buxheti i Shtetit. Ndërsa në rastin e trajtimit financiar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 ‘Për trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë’, të ndryshuar, përfitimet për minatorët jepen tërësisht nga Buxheti i Shtetit me arsyetimin se kjo kategori ngeli e papunë, madje pensionisti nuk paguan as kontributet e sigurimeve shoqërore pasi është Buxheti i Shtetit që i paguan këto të fundit.’”

Me shkresën⁵ nr. 4051/1 prot., datë 03.08.2020 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se kërkesat e subjekteve ankues kanë qënë jashtë fushës dhe kompetencave të saj, nisur nga ndjeshmëria që paraqet ky moment për pensionistët që kanë punuar në miniera në nëntokë, ka përcjellë për trajtim më shumë se një herë pranë Ministrisë së Financave dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kërkesat e subjekteve të interesuara në lidhje me këtë çështje.

Me shkresën⁶ nr. 2925/1, datë 04.06.2020, Instituti i Sigurimeve Shoqërore në mes të tjerash informoi Komisionerin mbi arsyet e mospërfitimit nga parashikimet e ligjit nr. 72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”, të subjekteve ankues.

- Në vijim të procedurës për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ju drejtua sërish Institutit të Sigurimeve Shoqërore me anë të shkresës nr. 527/5 prot., datë 01.10.2020, duke i kërkuar ndër të tjera:
 - Numrin e ish punonjësve të nëntokës, trajtuar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 ‘Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë’, të cilët kanë detyrime ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - Detyrimin e tyre të akumuluar ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore aktualisht.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 620/4 prot., datë 04.08.2020

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 620/2 prot., datë 08.06.2020

Me shkresën⁷ nr. 5942/1/1, datë 30.10.2020, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informoi Komisionerin rreth kërkesave të sipërcituara mbi numrin e ish-punonjësve të nëntokës, të cilët kanë detyrime ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe detyrimin e tyre të akumuluar ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori dijeni se Kuvendi i Shqipërisë më datë 23.12.2020, miratoi Ligjin Nr. 167/2020 *“Për faljen e detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore, që Ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfitur, sipas Ligjit Nr. 8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”*.

Në objekti të këtij ligji është parashikuar se: *“Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”*.

Në nenin 4 të këtij ligji, është përcaktuar: *“1. Falen gjobat e përlllogaritura nga sistemi i sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”, sipas gjendjes së papaguar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

2. Falen detyrimet e vendosura, që janë evidentuar sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë ankimuar dhe janë në proces ankimi administrativ ose në proces gjyqësor.

3. Periudhat e mbuluara me kontribute të derdhura për të cilat është likuiduar detyrimi i llogaritur nga përfitimi i paguar, do të njihen si periudha sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë.”

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*. Komisioneri vlerëson vendimin e Kuvendit të Shqipërisë lidhur me miratimin e Ligjit Nr. 167/2020 *“Për faljen e detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore, që Ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfitur, sipas Ligjit Nr. 8685, datë 09.11.2000, “Për një*

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1524 prot., datë 05.11.2020

trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”.

Për sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesat e subjekteve ankues, referuar të cilave Komisioneri nisi procedurën e shqyrtimit ex-officio janë plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të faljes së detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore, që Ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar, sipas Ligjit Nr. 8685, datë 09.11.2000.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ex-officio në lidhje me faljen e detyrimeve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë)

(Fush: Të mira dhe shërbime)